

Avantazhet dhe Disavantazhet e lidhjes emocionale të infermierëve dhe pacientëve kronik

Zefaj Mirlinda¹; Hysenaj Arben¹

Kolegji Heimerer¹

Hyrja: Që nga pjesa e mesme e shekullit të 20-të, marrëdhënia infermierë-pacient në aspektin e parë të ndërveprimeve njerëzore, aftësive të shkëlqyera të komunikimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë është shfaqur si një koncept qendror në teorinë dhe praktikën e infermierisë (Crowley, 2003; Narayanasamy, 2004). Zhvillimi dhe mbështetja e një marrëdhënie terapeutike infermiere-pacient është një rol thelbësor i punës infermiere.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të identifikohen avantazhet dhe disavantazhet e lidhjes emocionale midis infermierëve dhe pacientëve kronik.

Metodologjia: Hulumtimi është realizuar në Kosovë në dy qytete. Në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës “Isa Grezda” dhe në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës. Pyetësi është zhvilluar kryesisht në reparte të caktuara si: Interno, Neurologji, Pulomologji, Hemodializë dhe në kujdes intensiv. Instrumenti i cili është përdorur për hulumtimin e avantazheve dhe disavantazheve të lidhjes emocionale të infermierëve dhe pacientëve është pyetësi “The Nursing Care Interpersonal Relationship Questionnaire (NCIRQ)” i themeluar në Brazil në vitin 2015. Ky pyetësor përmban dy dimensione: pjesa e parë paraqet relacionin infermier-pacient dhe pjesa e dytë paraqet të dhënat demografike.

Konkluzionet: Sipas hulumtimit lidhja emocionale në mes të infermierëve dhe pacientëve konsiderohet avantazh për trajtimin e sëmundjes. Që do të thotë sa më të mira që janë raportet infermier – pacient aq më e madhe është mundësia e shërimit. Në bazë të këtij hulumtimi arrijmë po ashtu të identifikojmë rëndësinë e lidhjes emocionale në mes të infermierëve dhe pacientëve dhe mënyrën se si ndikon lidhja emocionale në trajtimin e sëmundjes. Me anë të këtij hulumtimi janë ofruar po ashtu informata objektive për natyrën e suksesshme të lidhjes emocionale të infermierëve me pacientët.

Fjalët kyçe: avantazhet, disavantazhet, lidhja emocionale, infermier, pacient